

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6913
E hënë, 5 qershor 2023
Çmimi 0.40

Të paktën 500 fëmijë ukrainas të vrarë në luftë

 | FAQE 2

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

VAZHDOJNË THIRRJET PËR ULJE TENSIONESH DHE ZGJEDHJE TË REJA NË VERI

| FAQE 4-5



Faktori Ndërkombëtar ka vazhduar thirrjet që Kosova dhe Serbia të marrin veprime për ta shtensionuar situatën në veri të Kosovës kur për më shumë se një javë po mbahen protesta para

ndërtesave të komunave. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian kanë bërë thirrje që të dyja palët të angazhohen në dialog dhe të punojnë për krijimin e kushteve për

mbajtjen e zgjedhjeve të reja në katër komunat veriore. As presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti nuk e kanë përjashtuar mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të reja në veri

TURQIA NIS TRUPAT E SAJ NË KOSOVË PËR TA PËRFORCUAR KFOR-in

 | FAQE 3

HAMZA NËNSHKROI KONTRATAT E BURSIVE PËR 230 STUDENTË

 | FAQE 6

AKTUALE



KOMPANITË AJRORE: TË GATSHME
TA SHMANGIM KAOSIN E VITIT TË
KALUAR NË UDHËTIME

 | F. 2

MOT I PAQËNDRUESHËM DERI
MË 12 QERSHOR

 | F. 6

OSMANI NË INAUGURIMIN E
ERDOGANIT PRESIDENT:
VAZHDOJMË BASHKËPUNIMIN

 | F. 3

EKONOMI



TENSIONET NË VERI SHQETËSOJNË
INVESTITORËT E HUAJ

 | F. 8

SPORT



LIRIA RIKTHEHET NË SUPERLIGË
PAS KATËR VJETËSH

 | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Të paktën 500 fëmijë ukrainas të vrarë në luftë

KIEV, 4 QERSHOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë të dielën se lufta e Rusisë, tani në muajin e 16, i ka lënë të vdekur të paktën 500 fëmijë ukrainas. Zelensky i ka bërë këto deklarata pas operacionit të nxjerrjes së trupit të një dyvjeçareje nga rrënojat, e cila ka vdekur të shtunën në qytetin ukrainas Dnjipro si pasojë e sulmeve ruse.

Presidenti ukrainas ka thënë përmes një deklarate se "armët ruse dhe urrejta, e cila vazhdon të marrë dhe t'i shkatërrojë jetët e

fëmijëve ukrainas çdo ditë", i ka vrarë qindra fëmijë, prej nisjes së luftës më 24 shkurt 2022. "Shumica prej tyre do të mund të bëheshin shkencëtarë të njohur, artistë, kampionë sporti, apo të kontribuonin në historinë ukrainase", ka thënë ai.

Zelensky ka thënë se është e pamundshme që të dihet numri i saktë i fëmijëve që kanë vdekur për shkak të konfliktit të vazhdueshëm dhe për faktin se disa territore ukrainase tani janë nën pushtimin rus. "Ne duhet të mbahemi dhe ta fitojmë këtë

luftë!" ka thënë presidenti ukrainas. "E gjithë Ukraina, të gjithë njerëzit, të gjithë fëmijët, duhet të çlirohen prej këtij tmerrri rus".

Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.



Stoltenbergu, Erdoganit: Suedia i ka përmbushur obligimet për anëtarësim në NATO



BRUKSEL, 4 QERSHOR - Shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, i ka bërë thirrje të dielën Ankarasë që ta ndryshojë qasjen kundërshtuese ndaj anëtarësimit të Suedisë në aleancën veri-atlantike. Sipas tij, Stokholmi i ka adresuar shqetësimet e Turqisë lidhur me sigurinë. "Suedia ka marrë hapa konkretë për t'i shmangur shqetësimet e Turqisë", u ka thënë Stoltenbergu gazetarëve pas

takimit me Erdoganin. "Suedia i ka përmbushur të gjitha obligimet".

Shefi i NATO-s ka marrë pjesë të shtunën në inaugurimin e Erdoganit, i cili e ka nisur edhe një mandat presidencial pesëvjeçar. Turqia, anëtare e NATO-s, është duke e bllokuar anëtarësimin e Suedisë në aleancë. Ajo dhe Hungaria janë të vetmet vende anëtare që nuk e kanë ratifikuar

aplikimin e Suedisë.

Finlanda, me të cilën Suedia ka aplikuar për anëtarësim, i është bashkuar aleancës në prill.

Erdogani e ka akuzuar Suedinë se është kthyer në strehë për "terroristët", sidomos për pjesëtarët e Partisë Popullore të Kurdistanit (PKK).

Ky grup është në listën e zezë të Turqisë dhe aleatëve të saj perëndimorë.

Dhjetëra mijëra persona protestojnë kundër qeverisë polake

VARSHAVË, 4 QERSHOR - Gjysmë milioni protestues kanë dalë të dielën në qendër të Varshavës, kanë thënë organizatorët opozitarë në Poloni, duke pretenduar se është regjistruar demonstrata më e madhe kundër qeverisë në 30 vjet pas dhënies fund të komunizmit. Lech Walesa, ish-president polak, fitues i Çmimit Nobel për Paqe, dhe lider i luftës kundër komunizmit, u është bashkuar figurave opozitare në krye të marshit. Protesta është organizuar para zgjedhjeve legjislativë që mbahen në Poloni në vjeshtën e këtij viti. Njerëzit kanë udhëtuar nga i gjithë shteti, pasi ish-kryeministri Donald

Tusk, udhëheqës i partisë opozitare të qendrës, Platforma Civile (PO), ka bërë thirrje për protesta "kundër çmimeve të larta të jetesës, kundër gënjeshtrave, për demokraci, për zgjedhje të lira dhe për Bashkimin Evropian".

Liderët e shumicës së partisë opozitare u kanë bërë thirrje mbështetësve që t'i bashkohen marshit kundër partisë në pushtet, Ligji dhe Drejtësia, e cila e ka në krye Jaroslaw Kaczynskin. "Vlerësohet se numri i protestuesve është 500 000 tani", ka thënë zëdhënësi i organizatorëve të protestës, Jan Grabiec. Protestuesit janë parë duke i

mbajtur mbishkrimet "Mjaft është mjaft", "Jo Polonisë autoritare", si dhe e kanë fajësuar partinë në pushtet për rritjen e çmimeve. Dikur udhëheqës i Këshillit Evropian, Tusk, u ka thënë protestuesve se roli i opozitës është "i një rëndësie të njëjtë" me atë të viteve 1980.

Walesa, i cili ka kohë që nuk është aktiv në politikë, u thënë protestuesve se është në pritje të ditës kur partia nacionaliste dhe Kaczynski do të largohen nga pushteti. "Zoti Kaczynski, kemi ardhur për ty. Ajo ditë ka ardhur", ka thënë Walesa.

Protesta e 4 qershorit është



mbajtur anë ditën kur është shënuar 34-vjetori i mbajtjes së zgjedhjeve pjesërisht të lira në Poloni pas rënies së komunizmit

në Evropë.

Walesa është bërë presidenti i parë i kombit i zgjedhur në mënyrë demokratike më 1990.

Kompanitë ajrore: Të gatshme ta shmangim kaosin e vitit të kaluar në udhëtime

STAMBOLL, 4 QERSHOR - Kompanitë ajrore kanë thënë të dielën se i kanë bërë përgatitjet për ta shmangur përsëritjen e kaosit të shkaktuar në udhëtime vitin e kaluar. Megjithatë, ato kanë paralajmëruar se disa fluturime do të mund të anulohen për shkak të grevave që po organizohen, kohë pas kohe, në disa aeroporte. "Kam besim që do të mund t'ia dalim pikut të këtij sezoni në verë, pa shumë probleme", ka thënë Willie Walsh, drejtor i përgjithshëm i Asociacionit Ndërkombëtar të Transportit

Ajror (IATA).

Liderët e kompanive ajrore, që kanë marrë pjesë në takimin vjetor të IATA-s, në Stamboll, i kanë shprehur shqetësimet e tyre për problemet eventuale në fluturimet brenda Evropës, si dhe në ShBA. "Megjithatë, sa kanë mundur, ata i kanë kryer obligimet e tyre, për t'i siguruar të gjitha burimet e nevojshme këtë verë. Besoj se shumica e aeroporteve do të jenë në gjendje të mirë. I kemi marrë mësimet nga vera e kaluar", ka thënë Walsh për agjencinë e lajmeve "Reuters".

Interesimi shumë i madh për fluturime, pas pandemisë së koronavirusit, dhe kombinimi me mungesë të stafit, patën shkaktuar kaos në aeroportet në Evropë dhe Amerikën e Veriut verën e kaluar.

Rritja e numrit të mospajtimeve në mes të udhëtarëve dhe kompanive i ka rritur thirrjet për kompensim më të madh të pasagjerëve.

Legjislatiioni është duke u rishikuar në Kanada, derisa qeveria amerikane është duke hartuar rregulla të reja. Në Bashkimin Evropian është

duke u bërë presion për zbatim më të mirë të rregulloreve, që përcaktojnë kompensim për udhëtarët në rastet e vonesave më shumë se tri orë. Mirëpo, Walsh ka thënë se janë konsumatorët, ata që do të paguajnë rritjen. "Sa më shumë që të ketë shpenzime kompania, aq më shumë barra do të reflektohet në bileta. Është ambient shumë i rëndë për të operuar".

Kompanitë ajrore kanë thënë se interesimi për të udhëtuar këtë verë është shumë i madh dhe i ka arritur nivelet para

shpërthimit të pandemisë së koronavirusit.

Për koronavirusin e ri është raportuar për herë të parë në dhjetor të vitit 2019 në Vuhan të Kinës.

Organizata Botërore e Shëndetësisë e pati shpallur koronavirusin pandemi më 11 mars të vitit 2020. Më shumë se 6.7 milionë njerëz kanë vdekur që prej shpërthimit të pandemisë në gjithë botën. Shtetet e Bashkuara kanë regjistruar numrin më të madh të viktimave, të përcjella nga India dhe Brazili.

Rama shpallet "Qytetar Nderi" në komunën Vaccarizzo Albanese në Kalabri

TIRANË, 4 QERSHOR - Kryeministri Edi Rama ndodhet sot për një vizitë në Kalabri të Italisë, ku dhe është shpallur "Qytetar Nderi" i komunës Vaccarizzo Albanese. Në fjalën e tij, Rama tha se

kultura arbëreshe është një gur i çmuar i historisë dhe traditës. Ai tha se në komunën Vaccarizzo Albanese është historia e një pjese të lirisë së Shqipërisë. "Faleminderit për nderimin,

qytetar nderi i Vaccarizzo Albanese, aty ku kultura arbëreshe është një gur i çmuar i historisë dhe traditës", u shpreh ai. Rama u shoqërua në këtë aktivitet nga bashkëshortja Linda

Rama si dhe të zgjedhur të pushtetit vendor si kryetarja e bashkisë së Durrësit, Emiriana Sako, kryetari i bashkisë së Shkodrës, Benet Beci dhe kryetari i bashkisë së Vlorës, Ermal Dredha.



Turqia nis trupat e saj në Kosovë për ta përforcuar KFOR-in

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Ministria turke e Mbrojtjes ka konfirmuar të dielën nisjen e një numri të ushtarëve turq në Kosovë si përfundim për misionin e NATO-s në Kosovë, KFOR.

Përmes disa pamjeve të publikuara në "Twitter", autoritetet turke kanë thënë se pas ngjarjeve të fundit në Kosovë, batalioni i Brigadës 65 të Mekanizuar të Këmbësorisë është nisur drejt Kosovës.

Prej 29 majit serbët lokalë të komunave veriore - Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok - janë duke protestuar për ta kundërshtuar hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në ndërtesat komunale.

Më 29 maj situata është përshkallëzuar në Zveçan pas përplasjes së protestuesve serbë me pjesëtarë të KFOR-it.

Për pasojë janë plagosur 30 pjesëtarë të forcës paqeruajtës dhe 52 serbë.

Vetë shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, e ka dënuar rëndë dhunën ndaj pjesëtarëve të KFOR-it.

Dhuna e ka nxitur NATO-n që të angazhojë 700 trupa shtesë në Kosovë, përveç 4 000 trupave që veçse janë në këtë shtet.

Faktori ndërkombëtar ka bërë thirrje të vazhdueshme për marrjen e hapave drejt uljes së tensioneve. Në mesin e kërkesave janë tërheqja e kryetarëve nga



ndërtesat komunale dhe pezullimi i operacioneve policore në ato ndërtesa në veri. Disa diplomatë kanë kërkuar edhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja në veri.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kanë dhënë shenja se mund të ndodhë diçka e tillë. Sa i përket Serbisë, faktori

ndërkombëtar ka kërkuar nga ky shtet që ta ulë gjendjen e gatishmërisë ushtarake dhe të ndihmojë në uljen e tensioneve në mesin e protestuesve serbë në veri. Kosova dhe Serbia, me

ndërmjetësim të BE-së, i kanë nisur negociatat për normalizim të marrëdhënieve më 2011. Palët i kanë nënshkruar disa marrëveshje, por jo të gjitha janë zbatuar.

Basha nga Lezha 'sulmon' Berishën për shkatërrimin e PD-së



TIRANË, 4 QERSHOR - Ish-kryetari i PD-së, Lulzim Basha, ka zhvilluar një bashkëbisedim me demokratë të Lezhës. Ai ka thënë se 'lufta' që nisi brenda PD-së për interesa personale të një personi dëmtoi interesat e demokratëve dhe shqiptarëve. "Unë e bëra përpjekjen time, duke bërë një hap pas për ta ndaluar këtë luftë, por asgjë nuk ndryshoi. Lufta vazhdoi, akuzat, mashtrimet ndaj meje dhe kujtdo që nuk

ishite dakord, që ne të sakrifikonim marrëdhëniet me ShBA-në dhe Britaninë e Madhe për interesat e një personi, u shpall armik, i shitur, i blerë, peng e gjithfarë lloj sulmesh", ka thënë ai.

Basha ka thënë se ai nuk ia kthej me të njëjtën gjuhë. "Jo se s'kam çfarë të them, por sepse e dija se një luftë e tillë do ta shkatërronte Partinë Demokratike. Ajo që shpresova me tërheqjen dhe me

heshtjen time nuk ndodhi! Gjërat u përkeqësuan edhe më tej. 14 maji e faktoi këtë! Por sot është e qartë se çfarë i duhet Partisë Demokratike, se çfarë presin shqiptarët prej saj. Nuk ka asnjë dyshim që Partia Demokratike është e vetmja forcë që do ta sjellë ndryshimin në Shqipëri. Natyrisht siç ka ndodhur edhe më parë, me mbështetjen e ShBA-së, Britanisë së Madhe dhe BE-së", ka theksuar Basha.

Osmani në inaugurimin e Erdoganit president: Vazhdojmë bashkëpunimin

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e shoqëruar nga Zotëria i Parë Prindon Sadriu, ka marrë pjesë në ceremoninë e inaugurimit të Presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan. "Dje në Ankara, në

ceremoninë inauguruese, e përgëzuar presidentin Rexhep Tajip Erdogan për rizgjedhjen, duke shprehur përkushtimin e plotë të Republikës së Kosovës për ta vazhduar bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve tona", ka

shkruar Osmani në "Facebook". Ajo ka theksuar se gjatë ceremonisë, me liderë të tjerë e miq të Kosovës, bashkëbiseduan për rëndësinë e bashkëpunimit në këtë kohë përcaktuese për sigurinë e përbashkët.





Vazhdojnë thirrjet për ulje tensionesh dhe zgjedhje të reja në veri

Faktori ndërkombëtar ka vazhduar thirrjet që Kosova dhe Serbia të marrin veprime për ta shtensionuar situatën në veri të Kosovës kur për më shumë se një javë po mbahen protesta para ndërtesave të komunave. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian kanë bërë thirrje që të dyja palët të angazhohen në dialog dhe të punojnë për krijimin e kushteve për mbajtjen e zgjedhjeve të reja në katër komunat veriore. As presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti nuk kanë përjashtuar mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të reja në veri

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Policia e Kosovës ka bërë me dije të dielën se situata në komunat në veri, Mitrovicë e Veriut, Zvečan, Zubin Potok dhe Leposaviq, ka qenë e qetë. Diplomacia perëndimore ka vazhduar thirrjet që Kosova dhe Serbia të marrin veprime për ta shtensionuar situatën në veri të Kosovës kur për më shumë se një javë po mbahen protesta para ndërtesave të komunave.

I dërguari amerikan për

Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka folur për BBC-në lidhur me tensionet në veri të Kosovës. Ai ka thënë se përshkallëzimi i tensioneve në veri ka qenë i shmangshëm. “Ky përshkallëzim ka qenë pjesërisht rezultat i mosgatishmërisë së palës kosovare që ta dëgjojë komunitetin ndërkombëtar. Ajo i ka provokuar tensionet, në mënyrë të panevojshme, duke insistuar në shfrytëzimin e objekteve komunale. Ekzistojnë ndërtesa të tjera prej të cilave mund të bëhet puna dhe, nëse asgjë tjetër,

pandemia e koronavirusit na ka mësuar që mund të punojmë edhe nga lokacione alternative”, ka thënë ai.

Escobari ka thënë se përpjekjet e faktorit ndërkombëtar për t’u koordinuar me Qeverinë e Kosovës kanë hasur në rezistencë. “Nuk ka pasur nevojë që të shkohet në ato ndërtesa. Ato nuk e kanë ndonjë vlerë reale. Ato janë kryesisht të thata tani. Kurti na ka siguruar që ata kryetarë do të ushtrojnë vetëm autoritetet administrativ, për të kryer shërbime bazike komunale”. Escobari ka përsëritur se duhet



të thyhet cikli i dhunës dhe se të dyja palët, si Kosova ashtu edhe Serbia, kanë përgjegjësi për të vepruar në atë drejtim. “Shumë pjesëtarë të komunitetit ndërkombëtar janë duke e parë këtë situatë si përballje në mes të Kosovës dhe Serbisë, por na duhet ta kujtojmë se këtu ekziston edhe një dështim për të arritur pajtim etnik brenda Kosovës. Ne i kemi inkurajuar të dyja palët që të angazhohen në dialog”, ka deklaruar Escobar, i cili bashkë me të dërguarin evropian për Ballkanin Perëndimor, Mirosllav Lajçak, do ta vizitojnë Kosovën dhe Serbinë më 5 dhe 6 qershor.

Më 30 maj ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se si pasojë e moskoordinimit të Qeverisë së Kosovës me ShBA-në, për veprimet në veri, Prishtina është përjashtuar nga stërvitjet më të mëdha ushtarake të aleatëve të NATO-s në rajonin e Ballkanit, Defender Europe 2023.

Edhe këshilltari i lartë i Departamentit Amerikan të Shtetit, Derek Chollet, ka shkruar të shtunën në rrjetet sociale se ka biseduar për këtë çështje me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, duke e inkurajuar “ts nxisë qetësinë mes serbëve të Kosovës, të ndërmarrë hapa për të ndihmuar në zbutjen e krizës në veri të Kosovës dhe të kthehet në rrugën e normalizimit dhe angazhimit konstruktiv në dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian”.

Po ashtu, Shtëpia e Bardhë ka njoftuar se zëvendëskëshilltari amerikan për siguri kombëtare, Jon Finer, ka biseduar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, duke

shprehur shqetësimin e Shteteve të Bashkuara për situatën në veri.

Finer kërkoi nga Qeveria e Kosovës t’u mundësojë kryetarëve të sapozgjedhur të komunave që t’i kryejnë detyrat e tyre nga vendndodhje alternative dhe t’i tërheqë forcat policore nga ndërtesat komunale. Ai, gjithashtu, përshëndeti gatishmërinë e kryeministrit Kurti për të punuar për krijimin e kushteve për zgjedhje të reja. Ai i bëri thirrje presidentit serb që të marrë masa për qetësimin e gjendjes, duke tërhequr forcat e armatosura serbe të stacionuara afër kufirit dhe ta ulë gjendjen e gatishmërisë, si dhe t’u bëjë thirrje protestuesve që ta ruajnë qetësinë në veri të Kosovës.

Bashkimi Evropian u bëri thirrje palëve që menjëherë dhe pa kushte të marrin masa për t’i ulur tensionet dhe të punojnë për vendosjen e qetësisë në veriun e trazuar të Kosovës, duke paralajmëruar se dështimi për të bërë një gjë të tillë do të ketë pasojë negative për të dyja palët.

BE-ja pret që Kosova t’i pezullojë menjëherë operacionet policore në afërsi të ndërtesave komunale në veri të Kosovës, kryetarët e komunave t’i kryejnë përkohësisht detyrat e tyre në objekte të ndryshme nga ndërtesat komunale dhe t’i shpallë zgjedhjet e parakohshme sa më shpejt në të katër komunat.

Bloku tha se pret, po ashtu, që serbët e Kosovës të marrin pjesë në zgjedhje, ndërkaq shprehu shqetësimin për gjendjen e gatishmërisë më të lartë të forcave të armatosura të Serbisë.

Kryesuesi i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në

Evropë, Bujar Osmani, publikoi një udhëzues prej nëntë pikash për ta siguruar shtensionimin dhe normalizimin, paqen dhe qëndrueshmërinë në Kosovë.

Në një postim në rrjetet sociale, Osmani shkroi se pikë e parë e këtij udhëzuesi është që Kosova dhe Serbia t’i rikonfirmojnë zotimet për zbatim të marrëveshjeve të Brukselit dhe Ohrit. Në pikën e dytë propozohet që Kosova t’i tërheqë njësitet e posaçme të policisë, ndërsa Serbia ta heqë gjendjen e lartë të gatishmërisë luftarake.

Më tej në propozim thuhet se policia e Kosovës me ndihmën e KFOR-it dhe EULEX-i duhet ta menaxhojnë sigurinë në terren.

Mes të tjerash, thuhet se kryetarët e zgjedhur të komunave në veri duhet të dorëhiqen gjatë verës për t’u hapur rrugë zgjedhjeve të reja që do të mbaheshin deri në fund të vitit.

Kryesuesi i OSBE-së tha se organizata e tij do ta mbështesë procesin zgjedhor dhe rritjen e mirëbesimit në mes të komuniteteve.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, duke dhënë disa detaje për takimin që zhvilloi me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq në Moldavi, ka konfirmuar se mund të mbahen zgjedhjet në katër komunat në veri të vendit, gjithnjë duke respektuar legjislacionin në fuqi. “Unë i informova se korniza jonë ligjore e lejon mundësinë e zgjedhjeve në veri dhe jemi të gatshëm ta konsiderojmë atë në përputhje me ligjin e Kosovës për zgjedhjet. Kjo do të thotë se qytetarët serbë, rreth 20 % e tyre që janë në listat zgjedhore, mund të nënshkruajnë një peticion dhe përmes kësaj, mund ta iniciojnë procesin e zgjedhjeve

të reja dhe ne jemi të gatshëm ta zbatojmë ligjin”, ka thënë Osmani.

Osmani në një konferencë për medie, në kuadër të samitit të dytë të liderëve të Komunitetit Politik Evropian, shtoi se nuk kishte plane ta takonte presidentin e Serbisë, por ndodhi pas këmbënguljes nga shumica e liderëve evropianë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se nuk mund të ketë kryetarë të rinj në katër komunat në veri, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, pa zgjedhje të reja. “Unë e kuptoj që zgjedhjet që janë mbajtur në veri të Kosovës kanë pasur dalje shumë të ulët dhe legjitimiteti është i vakët, mirëpo këta kanë pak legjitimitet e ata të tjerët kanë aspak legjitimitet”, ka deklaruar Kurti.

Sipas tij, gjithçka është duke shkuar drejt normalizimit dhe se kjo do të mund të bëhej edhe më shpejt “po të mos ishin obstrukcionet e Beogradit”.

“Për t’u bërë normalizimi, adresa ku duhet të bëhet trysnia nuk është Prishtina, që është kryeqyteti i shtetit më demokratik, e me policinë më profesionale në Ballkanin Perëndimor, por është Beogradi, i cili nuk distancohet nga krimet e [ish-liderit serb, Slobodan] Millosheviqit”, ka thënë Kurti.

Ndërkaq të dielën për BBC-në kryeministri Kurti ka thënë se nuk mund të bëjë kompromis me republikën demokratike dhe se ndërtesat komunale në tri komunat në veri Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan janë asete të Republikës së Kosovës.

Ai ka thënë se Kosova mund ta zvogëlojë numrin e zyrtarëve policorë në ndërtesat komunale, nëse paraprakisht, ato, që ai i ka cilësuar banda - të financuara nga Beogradi - të

shkojnë “ose në Serbi, ose në burgje”. “Në këto tri komuna, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, i kemi tri ndërtesa, dhe nëse jo kryetarët, atëherë kush duhet të jetë në to? Nëse nuk janë për kryetarët, kujt i shërbejnë ato? Kryetarët janë në zyrat e tyre, dhe kështu duhet të jetë. Ato ndërtesa janë asete të Republikës së Kosovës. Dikur kanë qenë struktura paralele të Serbisë, por ato janë struktura ilegale, të krijuara me fonde të Beogradit zyrtar, i cili dëshiron ta destabilizojë shtetin tonë, me idenë e Beogradit për të krijuar një botë të madhe serbe. Ne e kundërshtojmë diçka të tillë”, ka thënë Kurti.

Nën trysninë perëndimore udhëheqësit e Kosovës dhe të Serbisë janë pajtuar që zgjedhjet e reja duhet të mbahen në komunat veriore të banuara me shumicë serbë, por kanë akuzuar njëri-tjetrin për tensionet.

Tensionet në veri të Kosovës pasuan zgjedhjet e 23 prillit, të cilat u bojkotuan nga partitë serbe. Kryetarët komunash u zgjodhën kandidatët e partive shqiptare dhe dërgimi i tyre në zyrat komunale nxiti reagimin e palës serbe që u hodh në protesta. Të hënën protestuesit u përplasën me forcat paqeruajtëse të NATO-s. Përplasjet lanë pas vetes 30 ushtarë të plagosur dhe nxitën shqetësimin për ripërtëritje të konfliktit në rajonin e trazuar. Serbët lokalë janë duke protestuar rregullisht prej 29 majit në këto komuna, për ta kundërshtuar hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në ndërtesat komunale.

NATO-ja ka njoftuar se 700 trupa shtesë do të vendosen në Kosovë dhe trupa të tjerë janë në gatishmëri për t’iu bashkuar forcave paqeruajtëse nëse është e nevojshme.



Hamza nënkroi kontratat e bursave për 230 studentë



MITROVICË, 4 QERSHOR - Në hapësirat e Muzeut të Qytetit, kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka nënshkruar kontratat për bursa me 230 studentë për vitin akademik 2022/2023. Me rastin e nënshkrimit të kontratave, i pranishëm ishte edhe drejtori i Drejtorisë së Administratës, z. Gëzim Stavileci, i cili i ka përgëzuar të gjithë studentët bursistë të cilët, falë angazhimit

të tyre, kanë arritur t'i përmbushin kriteret e të jenë përfitues të bursës komunale. Ndërsa në fjalën e tij, kryetari Hamza ka thënë se me bindje të plotë i qëndron fjalës së tij se investimi në arsim është investimi më i nevojshëm në shoqërinë tonë, duke shtuar se financimi i bursave asnjëherë nuk llogaritet si shpenzim, përkundrazi është investimi më i duhur për të ardhmen.

“Ndihem shumë krenar që kemi arritur ta rritim numrin edhe për 180 bursa për studentët e Mitrovicës dhe padyshim që kjo mbështetje financiare nga institucionet lokale do të shërbejë si një motiv shtesë në ambicjet tuaja në rrugën e ngritjes dhe aftësimin profesional. Urime dhe suksese për të gjithë studentët”, është shprehur Hamza.

Komuna e Podujevës shpërndan farë dhe bimë mjaltëdhënëse për fermerët llapjanë

PODUJEVË, 4 QERSHOR - Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Vigan Salihu, në bashkëpunim me organizatën “EcoKosWomen”, kanë marrë pjesë në ceremoninë e shpërndarjes me bimë dhe fara mjaltëdhënëse për fermerët llapjanë, në kuadër të projektit “Gruaja dhe mbrojtja e ambientit përmes aktiviteteve bujqësore”.

Përmes këtij projekti i cili buron nga memorandumi i bashkëpunimit në mes të komunës së Podujevës dhe UNDP-së, organizata EKW ka shpërndarë fidanë të “Sherbeles” dhe farë të “Facelijas” të cilat shërbejnë si bimë mjaltëdhënëse për bujqit që merren me blegtori. Drejtori Salihu i uroi përfituesit e

këtij projekti i cili qëllim kryesor ka rritjen e prodhimit të mjaltës, dhe me këtë rast ai uroj për arritje të kënaqshme të rendimenteve për blegtarët tanë.

Ndërsa përfaqësuesja e EKW-së ka falënderuar komunën e Podujevës për bashkëpunimin dhe i ka uruar përfituesit duke u bërë thirrje për punë të vazhdueshme, si dhe duke i inkurajuar veçanërisht gratë që të aplikojnë në projekte të tilla.

Komuna e Podujevës ka njoftuar se do të vazhdojë projektet të cilat kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes së qytetarëve të Podujevës për mbrojtjen e ambientit dhe adaptimin në ndryshimet klimatike përmes aktiviteteve bujqësore.



Mot i paqëndrueshëm deri më 12 qershor



PRISHTINË, 4 QERSHOR - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) ka njoftuar se deri më 12 qershor do të ketë mot të paqëndrueshëm.

IHMK-ja ka njoftuar se të hënën do të ketë mot me diell dhe vranësira të cilat vende-vende do të shoqërohen me reshje shiu. Sa iu përket temperaturave, ato do të jenë të pandryshueshme në ditët e javës që po e lëmë. “E martë: Mot kryesisht i ngjashëm, diell dhe

vransira të cilat parashihen të sjellin shi. E mërkurë: Mot me diell dhe vranësira të cilat parashihen të sjellin reshje shiu. Reshje më të fokusuar do të jenë në relievin malor. E enjte: Mot i ngjashëm pothuajse me të gjithë elementët dhe dukuritë si në ditët e fundit. E premte: Mot i vranët dhe me intervale me diell. Temperaturat mbeten pothuajse konstante me ditët e fundit”, ka njoftuar IHMK-ja.

Gjithashtu, në njoftim thuhet se

shkarkime rufesh në shumë zona parashihen gati çdo ditë, por nuk përjashtohen mundësitë që në zona të izoluar të bie breshër si pasojë e ndryshimeve termike dhe barike. “Pra, siç po vërehet nga ky parashikim, situata meteorologjike mbetet e pandryshuar me ditët e fundit të majit dhe fillimit të qershorit. Gjykuar në aspektin territorial, reshjet me sasi më të mëdha”, ka njoftuar IHMK-ja.

Në shumicën e urave në Drenas vendosen muret mbrojtëse

DRENAS, 4 QERSHOR - Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria për Infrastrukturë, po vazhdon realizimin e projekteve infrastrukturore për lehtësimin e kryerjes së shërbimeve për qytetarët.

Drejtori për Infrastrukturë, Endrit Gllareva, bashkë me zyrtarët komunalë, ka vizituar

disa vendpunishte të ndërtimit të tombinave për t'i parë nga afër punimet.

“Sot, bashkë me zyrtarët e Drejtorisë për Infrastrukturë, inspektuam nga afër punimet në ndërtimin e tombinave të urave në Çikatovë të Vjetër, në lagjen Dubovci dhe lagjen Karaxha, në lagjen Hajdini në Terstenik, në

lagjen Rrukiqi në Verboc, në lagjen Kastrati në Polluzhë, dhe murin mbrojtës tek ura në Dobroshec, përkatësisht lagjja Fejza dhe Prenku”, ka theksuar ai.

Punimet janë duke vazhduar edhe në projekte të tjera me rëndësi për qytetarët e kësaj komune.



Po vazhdojnë punimet për ndërtimin e fushës sportive në fshatin Malësi e Vogël

Rahovec, 4 qershor - Po vazhdon, me dinamikë të shtuar, puna për ndërtimin e fushës sportive në fshatin Malësi e Vogël në komunën


e Rahovecit. Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Afrim Dina, së bashku me drejtoreshën e Shëndetësisë, Sarandë

Salltëku, vizituan punimet e rregullimit të fushës sportive në Malësi të Vogël. Me realizimin e këtij projekti të rinjtë do të kenë

infrastrukturë me standarde më të larta dhe do të rritet gama e aktiviteteve të tyre sportive.



Tensionet në veri shqetësojnë investitorët e huaj



PRISHTINË, 4 QERSHOR - Sa herë që ndodhin incidente në katër komunat e banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës, shqetësime paraqiten edhe te partnerët ndërkombëtarë të kompanisë së teknologjisë së informacionit 'Anchorzup', në Prishtinë. Kjo kompani ofron shërbime për tregun ndërkombëtar, përfshirë zhvillimin e softuerëve, uebfaqe, shërbime marketingu dhe shitjeje. Jeta Zagragja, themeluese dhe kryeshefe ekzekutive në kompani, shprehet se pas çdo trazire apo përshkallëzim të situatës në katër komunat e banuara me shumicë serbe (Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq), klientët nga shtetet evropiane dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës paraqesin shqetësime për mundësinë e rrezikimit të investimeve të tyre. "Interesohen në qoftë se duhet ndërprerë edhe bashkëpunimin. Gjithsesi paraqitet si jostabilitet i përgjithshëm në vend. Kemi pasur ankesa të tilla, por gjithmonë kemi arritur t'u tregojmë se (në veri të Kosovës) është një situatë më e izoluar, siç mund të ndodhë edhe në shtete të tjera të Evropës dhe botës dhe nuk afekton pjesën tjetër", thotë ajo.

Tensionet në veriun e banuar me shumicë serbe nisën më 26 maj pasi kryetarët e rinj, nën asistimin e Policisë së Kosovës, u futën në ndërtesat komunale. Qytetarët serbë në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok,

edhe më 29 maj protestuan për ta kundërshtuar hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në ndërtesat komunale. Revolta e tyre u shndërrua në përlëshje të dhunshme me pjesëtarë të misionit të NATO-s, KFOR, më 29 maj.

Zagragja: Situata aktuale shqetëson partnerët

Këto tensione, thotë Zagragja, shkaktojnë hezitime te partnerët, me të cilët janë në negociata për bashkëpunim. "Megjithatë, ende nuk e dimë si mund të afektojë kjo situatë tek investimet që ende nuk i kemi marrë. Me klientët që jemi duke punuar i kemi bindur, sepse ata kanë qenë këtu (në Kosovë), kemi folur drejtpërdrejt, por të tjerët mund të shqetësohen dhe të largohen", thotë ajo për "Radion Evropa e Lirë".

Sektori i IT-së në Kosovë është relativisht i ri dhe ka filluar të zhvillohet në fillim të viteve 2000, megjithatë ka arritur të ofrojë shërbime edhe në tregun ndërkombëtar.

Kompania 'Stree', me qendër në Ferizaj, merret me eksport të shërbimeve të softuerëve. Pronari i kësaj kompanie, Shkelzen Vishi, thotë se jo në të gjitha rastet e trazirave reagojnë partnerët ndërkombëtarë me të cilët bashkëpunojnë.

Klientët nuk janë shumë të informuar për situatën në Kosovë, shprehet ai, pasi shumica e kontratave lidhen në mënyrë

elektronike. Atyre u intereson shërbimi dhe jo vendi. "Vetëm në një rast ka ndodhur. Një partner nga Zvicra ka qenë në Kosovë për arsye biznesi dhe ndodhën trazira në veri të Kosovës. Ai u shqetësua dhe pyeti për stabilitetin e sigurisë", tregon Vishi.

Probleme të tilla nuk ka kompania amerikane 'Radix', që ka degë edhe në Prishtinë. Kjo kompani ofron shërbime për kompani të ndryshme në botë.

Pronari i saj, Visar Jasiqi, thotë se klientët i shfrytëzojnë shërbimet online dhe nuk preken nga situata aktuale në veri të Kosovës dhe as në të kaluarën nuk ka pasur ankesa të tilla.

Nuk është vetëm sektori i IT-se që po pëson nga trazirat në komunat e banuara me shumicë serbe. Për përshkallëzim të situatës në veri të Kosovës, autoritetet e Kosovës po fajësojnë "strukturat kriminale dhe ilegale" të Serbisë.

OEAK-u: Investitorët hezitojnë të investojnë në një vend të pasigurt

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka shprehur qëndrimin se normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të sillte përfitime për komunitetin e biznesit dhe rritjen e investimeve të huaja. "Çështjet e pazgjidhura mes dy vendeve kanë krijuar një mjedis të paqëndrueshëm që është dekurajues për bizneset e huaja

të investojnë në Kosovë, pasi investitorët hezitojnë të investojnë paratë e tyre në një vend me një nivel të lartë të pasigurisë politike, i cili rrit rreziqet që lidhen me investimet e tyre", thuhet në një komunikatë të kësaj ode më 16 maj.

Tensionet në veri u rritën, pasi kryetarët e rinj shqiptarë të Zubin Potokut, Leposaviqit dhe Zveçanit, bënë betimin në shkollë dhe ndërtesa të tjera komunale për shkaqe sigurie.

Kurse më 26 maj ata u asistuan nga Policia e Kosovës, pasi grupe të banorëve vendas kundërshtuan shkuarjen e tyre në zyrat në ndërtesat komunale që më parë përdorshin nga zyrtarët serbë.

Bashkësia ndërkombëtare e ka dënuar fuqishëm vendimin e Qeverisë së Kosovës, siç kanë thënë, "për të hyrë me forcë" në ndërtesat komunale në veri. NATO-ja kërkoi shtensionimin e

menjëhershëm të situatës.

Ndërkaq, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se gjendja e tanishme kërkon që të zbatohet marrëveshja bazë për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi si dhe të qetësohet situata në veri të Kosovës.

Në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian dhe mbështetet nga Shtetet e Bashkuara, më 27 shkurt palët arritën marrëveshjen bazë për normalizimin e raporteve, ndërkaq në mars u pajtuan për aneksin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Marrëveshja nuk parasheh njohjen e ndërsjellë, për të cilën insiston Kosova, por kërkon nga Kosova dhe Serbia t'i pranohet dokumentet dhe simbolet e njëra-tjetërës, përfshirë: pasaportat, diplomat dhe targat.

Për 15 vjet mbi 4.5 miliardë euro investime të huaja

Brenda 15 vjetëve të fundit vlera e investimeve të huaja direkte në Kosovë kap vlerën e mbi 4.5 miliardë eurove. Sektori i patundshmërive përbën sektorin me pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e investimeve të huaja direkte, pasuar nga sektori i financave dhe sigurimit.

Rrëfim shokues: Jack Smith akuzoi Hashim Thaçin për ta ruajtur vendin e punës, për karrierë dhe për të dëmtuar Trumpin



Gjykata Speciale do të shuhej duke kaluar edhe nëpër Këshillin e Sigurimit të OKB-së në vitin 2020. Për këtë ishin pajtuar ShBA, Kosova dhe Serbia. Akuzat për trafikim organesh janë trillim i Ruisë. Ka dëshmitarë që u mashtruan dhe u manipuluan nga njerëz që u paraqitën si agjentë të CIA-së.

Akuzat ndaj Hashim Thaçit nuk kanë bazë. Prokurori i parë amerikan i Gjykatës Speciale, David Schwendiman hetoi për disa vite dhe tha se nuk ka gjetur gjë për të ngritur aktakuza dhe pastaj dha dorëheqje. Erdhi Jack Smith në vend të tij. Në pranverë 2020 ai u njoftua fshehtë se Gjykata Speciale po mbyllet si pjesë e marrëveshjes historike mes Kosovës dhe Serbisë, që do të nënshkruhej në Shtëpinë e Bardhë. Dosjet nga Haga do të ktheheshin në gjykatat vendore në Kosovë dhe në Serbi.

Kur gjithçka ishte gati për zhbërje të Gjykatës dhe ish-presidenti Thaçi u nis për në Washington për të nënshkruar marrëveshjen në prani të presidentit Donald Trump, prokurori Smith lëshoi një deklaratë në të cilën njoftonte se kishte kërkuar të akuzohej presidenti Thaçi, Kadri Veseli

dhe të tjerë nga UÇK.

Pse e bëri e këtë prokurori Smith? Për ta ruajtur vendin luksoz të punës dhe jetën e mirë që bënte në Evropë bashkë me të tjerë. Për ambicie dhe karrierën e vet personale dhe për ta penguar një sukses historik të presidentit Trump sepse e urrente atë shumë. Smith ishte shumë i politizuar. Në këtë mënyrë shpëtoi Gjykata Speciale dhe u pengua një marrëveshje paqeje mes Kosovës dhe Serbisë. Thaçi dhe krerë të tjerë të UÇK-së u dërguan në Hagë. Pjesa e marrëveshjes për Gjykatën Speciale ra poshtë sepse tani ishte paralajmëruar aktakuza. Këto që i ndërmori kryeprokurori Jack Smith për të penguar shuarjen e Gjykatës Speciale përputhen me datat e hapave që po ndërmernte ShBA për finalizimin e marrëveshjes historike mes Kosovës dhe Serbisë.

Ky është rrëfimi i Richard Grenell, njeriut të afërt të presidentit Donald Trump, që e kishte caktuar në pozita të larta: Shef të të gjitha shërbimeve inteligjente amerikane, ambasador në Gjermani dhe emisar presidencial për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë.

Nuk është hera e parë që Grenell flet për këtë, por këto detaje shtesë, që janë shokuese, i ka shpalosur tani, në një intervistë për median e popullarizuar amerikane "The Epoch Tv", tek gazetari dhe publicisti amerikan Lee Smith. Shkas për këtë intervistë është fjalimi i kryeministrit Edi Rama para liderëve të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, në samitin në Islandë, që u mbajt më 17 maj. Aty Rama sërish foli për iniciativën e Shqipërisë për rrëzim të Raportit të Dick Martyt, akuzat e të të cilit për trafikim organesh nuk dolën të vërteta. Në këtë intervistë, Grenell fillon rrëfimin se si ishte dakorduar marrëveshja historike mes presidentëve Donald Trump, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vucic, ku përveç pakos ekonomike për të dyja vendet, ishte edhe anëtarësimi i Kosovës në OKB.

Në janar të vitit 2020, Grenell kishte biseduar me Bruce Schwartz, shef i Programit ndërkombëtar të Departamentit amerikan të Drejtësisë dhe për shkak se ky institucion merret edhe me prokurorët amerikanë që dërgohen në misione jashtë vendit, Grenell, ne mënyrë

konfidenciale e njofton se Gjykata për Kosovën në Hagë do të mbyllet.

Ky zyrtar, siç thotë Grenell, megjithatë e kishte kontaktuar prokurorin Smith dhe i kishte treguar se po mbetej pa punë në Hagë, bashkë me amerikanët tjerë që po punonin aty për vite me radhë.

"Reagimi i Bruce ishte, oh, oh, jo. Kemi prokurorë amerikanë në Hagë. Nuk e di se çfarë do të thonë. Dua të them, ne duhet t'i informojmë dhe t'i bëjmë të ditur, vetëm në rast se ata duan, ju e dini, të ngrënë aktakuza apo diçka tjetër. Dhe unë i thashë, mirë, nuk do t'ju tregoj si ta bëni punën tuaj. Por palët, Bruce, ndoshta jo në Departamentin e Drejtësisë, por palët (Kosova dhe Serbia) janë gati të ecin përpara pas 20 vjetësh. Dhe kështu ne do ta vendosim këtë në marrëveshje. Brenda javësh, ne kishim të dyja palët që vinin në Uashington për negociatat përfundimtare dhe kjo pikë do të jetë aty. Dhe çfarë ndodhi? Ndërsa Hashim Thaçi, presidenti i Kosovës, ishte duke bërë plane për të ardhur në Uashington DC për të më takuar mua në Shtëpinë e Bardhë për negociatat përfundimtare – dhe nëse i përfundonim negociatat, të

takoheshim me Presidentin Trump për ta nënshkruar atë – ai u padit nga gjykata. Jack Smith paditi presidentin e Kosovës derisa ai ishte duke ardhur për të negociuar për të hequr qafe punën e Jack Smith në Hagë", ka thënë Grenell.

Grenell shprehet i bindur se Bruce Schwartz i Departamentit të Drejtësisë ndihmoi prokurorin Jack Smith. "Por unë jam 100 për qind i sigurt që Bruce Schwartz informoi Jack Smith dhe tha, Grenell do të negociojë vendin tuaj të punës dhe të gjithë gjykatën. Dhe ata dolën me këto akuzat", thotë Grenell.

Në pyetjen e gazetarit se cilat ishin akuzat e prokurorit Smith kundër Thaçit, Grenell jep këtë përgjigje:

"Kishte një ide shumë kohë më parë se akuzat kundër Thaçit kishin të bënin me trafikimin e organeve njerëzore në kohën e luftës. Por kur ata ngritën aktakuzën, asnjë nga këto nuk ishte aty. Nuk kishte data. Nuk ka specifika. Dhe këtu është çelësi, disa nga dëshmitarët e asaj aktakuze tani kanë dalë dhe kanë thënë "unë thashë vetëm atë që thashë sepse personi që më intervistoi pretendonte se ishte nga CIA amerikane dhe ata thoshin se

kishin prova dhe donin që unë ta them këtë". Ai person tani është vërtetuar se nuk është person i CIA-s. Kushdo që ishte ai person, ai i ka gënjyer dëshmitarët. Dëshmitarët kanë ardhur (në Hagë) për të thënë se më kanë gënjyer, mendova se po punoja me CIA-n. A e dinte Jack Smith këtë? A i vuri ai këta njerëz të rremë të CIA-s për ta penguar këtë?

Akuzat që Jack Smith i ngriti ndaj presidentit të Kosovës nuk ishin ato që ai tha publikisht se do ta akuzonte, për marrjen e organeve njerëzore dhe trafikimin e tyre. Nuk ishte asnjë akuzë për këtë në aktakuzë. Të gjitha ishin akuza të përgjithshme, dhe Hashim Thaçi, presidenti i Kosovës është ende në burgun e Hagës edhe sot e kësaj dite".

Pse Jack Smith ndjeku presidentin e Kosovës? Për të shpëtuar punën e tij, pyeti në vijim të intervistës gazetari. Richard Grenell dha këtë përgjigje:

"Kjo është një pyetje vërtet e mirë. Ka një histori të gjatë të hetimit të të gjitha krimeve të luftës. Po e përsëris, kjo është arsyeja pse pika e rëndësishme është prokurori (David Schwendiman) që ishte kryeprokuror përpara Jack Smithit, i cili kaloi vite duke parë gjithçka dhe tha se nuk ka asgjë tjetër për të bërë këtu. Nuk ka më aktakuza. Pastaj

erdhi Jack Smith dhe ai kaloi vite duke jetuar në Amsterdam dhe duke pasur një jetë të mirë evropiane. Kur je kreu i një gjykate ndërkombëtare që jeton në Evropë, është një punë e qetë. Por pasi administrata Trump përmbysi plotësisht negociatat për Ballkanin, ne filluam të përparonim dhe nënshkruam katër marrëveshje.

Marrëveshja përfundimtare, marrëveshja më e madhe, do të ishte ajo historike që do të shuante gjykatat. Dhe unë mendoj se përgjigja, për mendimin tim, është se Jack Smith e pa administratën Trump duke bërë vërtet shumë përparim në Ballkan, dhe për Hashim Thaçin u raportua shumë në media si negociator. Dhe nëse shikoni mediat në atë kohë thoshin, ua, këta njerëz kanë nënshkruar tre marrëveshje, ata do të arrijnë një marrëveshje të madhe në Shtëpinë e Bardhë. Kjo mund të jetë shumë historike për normalizimin ekonomik. Dhe unë mendoj se ai i kishte letrat në dorë, sepse po hetonte Hashim Thaçin, për ta ndaluar këtë vrull".

Grenell thotë se Smith nuk kishte asnjë provë më shumë sesa Schwendiman i cili kishte ardhur në përfundim se nuk ka baza për aktakuza.

"Akuza ime është se ai u bë shumë politik vetëm sepse e urrente Donald Trumpin. Ai

vendosi se do të përpiquej t'i ndalte këto negociata, duke ngritur një aktakuzë. Po e përsëris, ata kishin folur publikisht për këtë aktakuzë si diçka që do të kishte të bënte me trafikimin e organeve njerëzore, diçka që është skandaloze nëse dikush akuzohet se e ka bërë këtë. Ai (Smith) nuk e vërtetoi këtë", ka thënë tutje Grenell.

Gjatë kësaj interviste të gjatë, Grenell flet sërish për përpjekjet e kryeministrit Rama që Evropa të korrigjojë padrejtësitë ndaj Kosovës dhe fton mediat, sidomos ato amerikane, që të merren me këto që i thotë në këtë intervistë.

"Dhe kështu tani kryeministri i Shqipërisë, aleati ynë në NATO, Edi Rama, i cili nuk është konservator, meqë ra fjala, ai doli para Këshillit të Evropës javën e kaluar për të ndëshkuar evropianët që lejuan që kjo gjykatë të padisë Hashim Thaçin, i cili është ende në burg. Evropianët e kanë lejuar këtë të ndodhë. Po të lexosh detajet e asaj që thotë Edi Rama, ai thotë se rusët janë ata që e nxorën këtë dezinformatë. Pra, pyetja do të ishte, a kanë paraqitur rusët dezinformata për Hashim Thaçin? Dhe a ra Jack Smith në këto shpifje? Mendoj se mediat tona amerikane duhet të bëhen shumë më kureshtarë se cilat janë lidhjet këtu. Akuzat janë

shpërthyesë".

Pyetja tjetër drejtuar Grenellit nga gazetari është: A mund t'ju kërkoj vetëm të sqaroni akuzat e bëra nga kryeministri shqiptar? Ai po pyet, a ishin rusët që ia dhanë këtë informacion prokurorit amerikan?

"Ajo që ai po thotë është, pse Evropa u mashtrua me akuza të rreme të sajuara kundër Hashim Thaçit, deri në pikën ku kjo gjykatë ndërkombëtare në Hagë, Jack Smith, e paditi dhe e arrestoi atë. Pse mashtrohen evropianët? Ai thotë turp për ne. Turp për të gjithë ne që e lejojmë këtë. Këto akuza të rreme për ta vënë presidentin e Kosovës në aktakuzë dhe arrestim dhe një çështje ligjore në vazhdim. Dhe, pranoni fjalët e kryeministrit të Shqipërisë, ato janë akuza të sajuara, janë akuza të rreme, dhe Jack Smith ishte prokurori".

Pyetja e radhës e gazetarit është: Pra, ka dy motive të mundshme që Smith të ketë ngritur këto akuza? Njëra, siç e përmendët më herët, ishte që ai të mbante punën e tij në Evropë. Por motivi tjetër ishte të pengonte një nismë të rëndësishme të politikës së jashtme të administratës Trump?

Richard Grenell përgjigjet: "Jack Smith është qartësisht ambicioz. Dhe ai mori punën në Hagë si kryeprokuror i

gjykatës dhe e mori detyrën duke e ditur se prokurori para tij (David Schwendiman), i hodhi poshtë dhe hoqi dorë. Jack Smith hyri në një punë ku dikush nuk ishte në gjendje të padisë presidentin e Kosovës. Dhe ai kaloi vite duke u përpjekur të dilte me akuza të reja, dhe publikisht kur e paditën Hashim Thaçin, nuk ka pasur akuza të reja, nuk ka data. Ka vetëm një përfundim për të dalë. Kur shikoni kohën dhe shikoni aktakuzën aktuale nga Jack Smith, ka vetëm një përfundim: Ai vendosi ta bënte atë kur Hashim Thaçi ishte disa ditë larg nga shkuarja në Shtëpinë e Bardhë për të nënshkruar këtë marrëveshje përfundimtare".


Ish-ambasadori Grenell thotë se prokurorët në Hagë po përpiqen të provojnë krimet e luftës përmes mungesës së udhëheqjes nga ana e krerëve të UÇK-së mbi pjesëtarët e saj. "Është e pabesueshme, një akuzë pa specifika", ka thënë Grenell.

Çfarë na tregon kjo për karakterin dhe metodat e njeriut që tani po udhëheq hetimin e Presidentit Donald Trump, ka qenë pyetja përmbyllëse e gazetarit në këtë intervistë.

"Ai është shumë politik dhe jashtëzakonisht ambicioz dhe egoist në motivet e tij", vlerëson Ish-ambasadori Grenell.



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Invert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Besa Famgas, kampione te juniorët

PEJË, 4 QERSHOR - Besa Famgas është kampione e Kosovës në grupmohën e juniorëve. Ekipi pejan në finale të ligës së juniorëve e mposhti Prishtinën me rezultat 43:33. Ndeshja vendimtare e Final4 të ligës

së juniorëve u zhvillua të dielën pasdite në Pallatin e Rinisë në Prishtinë. Besa nisi herët shkëputjen në rezultat dhe në minutën e 14-të rezultati ishte 13:5. Prishtina u afua, por jo mjaftueshëm sa për të rrezikuar

avantazhin e pejanëve. Në pjesën e dytë Prishtina u afua në tri gola, por Besa sërish bëri shkëputje dhe më pas nuk kishte telashe për ta kontrolluar lojën deri në fund. Edonis Hajra i shënoi 12 gola për Besa Famgasin.

Nga nëntë i kishin Amar Muqolli e Olsi Mulaj, derisa shtatë i realizoi Drin Radoniqi. Te Prishtina 12 gola i shënoi Elion Goçi. Lum Xhemajli shtoi shtatë gola, ndërsa gjashtë i kshte Edon Shaqiri.



Liria rikthehet në Superligë pas katër vjetësh

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Liria e Prizrenit rikthehet në Superligën e Kosovës pas katër vjetësh. Skuadra nga qyteti i lashtë objektivin e saj e arriti pasi në ndeshjen e barazhit për Superligë e mundi skuadrën e deritashme të elitës, Ferizaj, pas penaltive. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë në një atmosferë të shkëlqyeshme nga tifozët "Arpaxhikët" dhe "Ujqit" solli betejë të madhe në fushë, por asnjëra prej skuadra nuk arriti të gjejë rrugën e golit as pas 120 minutash. Kësisoj, fati i kësaj ndeshjeje por edhe i skuadrës që do ta siguronte

pjesëmarrjen në Superligë për edicionin e ardhshëm u vendos në serinë e penaltive. Aty futbollistët e Lirisë dolën më të suksesshëm, e ku më i merituari ishte portieri Dilon Hodaj, i cili priti dy penallti të ferizajsve. Kësisoj, në fund Liria fitoi 3:0, duke festuar rikthimin në elitë pas katër vjetësh garimi në Ligën e Parë. Paraprakisht prizrenasit kishin fituar në ndeshjen e barazhit me skuadrën e Ligës së Parë, Ulpianën. Në anën tjetër, Ferizaj rikthehet sërish një rang më poshtë, edhe pse në stinorin pranveror pati paraqitje mbresëlënëse në elitë.



Curri: Premtojmë maksimumin që ky trofe të mbetet në kryeqytet



PRISHTINË, 4 QERSHOR - Skuadra e Prishtinës e përmbyll edicionin kalendarik 2022/23, me ndeshjen finale të Kupës së Kosovës ndaj SC Gjilanit, sfidë e cila zhvillohet të hënën, nga ora 18:00, në stadiumin "Fadil Vokrri", në kryeqytet. Optimizmi në kampin "bardhekaltër" është maksimal për ta përmbyllur këtë edicion me trofe. FC Prishtina është kualifikuar për herë të 11-të në finale të Kupës së Kosovës, që nga pavarësimi i futbollit tonë. Nga 10 finale, Prishtina e ka fituar shtatë herë trofeun e çmuar të Kupës. Kjo përballje

do të jetë e veçantë edhe për trajnerin, Debatik Curri, i cili në vitin e parë si kryetrajner i Prishtinës synon trofe. Curri ka folur për finalen e së hënës, për faqen zyrtare të klubit, "prishtinafc.com". "Kjo është ndeshje shumë e rëndësishme për Prishtinën, një finale, e cila e përmbyll një vit shumë të mundimshëm dhe me shumë sakrifica. Trofetë kanë qenë prej fillimit objektivin jonë dhe normalisht se nesër do të synojmë që të kurorëzohemi me këtë trofe". "Përparësi e Prishtinës në këtë ndeshje është stadiumi "Fadil Vokrri" pasi luajmë

para qytetarëve të Prishtinës, para "Plisave", që mendoj se do të jenë shtytje e madhe për neve, për këtë trofe. Skuadra është përgatitur mjaft mirë. Të gjithë lojtarët kanë punuar maksimalisht dhe të gjithë janë të gatshëm që ta përmbyllim këtë vit me një trofe që është i rëndësishëm edhe për sfidat që i kemi pasur gjatë gjithë edicionit". "Ftoj të gjithë qytetarët dhe tifozët "Plisat" që të vijnë masovikisht në stadium për ta përkrahur ekipin në mënyrë që trofeun ta mbajmë në Prishtinë. Ne si ekip ju premtojmë maksimumin që nesër t'ju bëjmë të lumtur".

Verstappen triumfon në Barcelonë

Barcelonë, 4 qershor - Pas Monacos, Max Verstappen fiton edhe në Çmimin e Madh të Spanjës. Holandezi nuk e vendosi në diskutim suksesin duke qenë se e udhëhoqi garën nga fillimi në fund. Një garë e mirë edhe për dy makinat Mercedes me Lewis Hamilton që u rendit i

dytë dhe George Russell i treti. Në vendin e katërt u rendit, Sergio Perez, që arriti të përmirësohej me 11 pozicione nga starti. Vendi i pestë ishte maksimumi për Carlos Sainz që e mbylli garën në vendin e pestë ndërsa Charles Leclerc doli pa pikë duke e mbyllur

Çmimin e Madh të Spanjës në vendin e 12-të. Në dhjetëshen e parë pati vend për Stroll, Alonso, Ocon, Tsunoda dhe Zhou. Pas kësaj fundjave, Verstappen shkëputet edhe më shumë në krye të kampionatit me 144 pikë ndërsa ndiqet nga Sergio Perez me 105 pikë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients


[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues